

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Delushe Halimi e me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditësit K.B., nga F., të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Xh.M., nga P., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Inspektorati i MMPH-së në Prishtinë, për anulim e aktvendimit, në shqyrtimin kryesorë publik të mbajtur në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij e në mungesë të të paditurit, me dt.06.07.2016, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**Aprovohet** kërkesëpadia e paditësit K.B., nga F.. **Anulohet** aktvendimi i të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Inspektorati i MMPH-së në Prishtinë, me nr.4339/13, i dt.20.11.2013 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

## A r s y e t i m

Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, shqyrtimin kryesorë e mbajti në prezencë të paditësit dhe të autorizuarit të tij, e në mungesë të palës së paditur të ftuar me rregull, mungesën e ka arsyetuar me parashitësën e datës 06.07.2016.

I autorizuari i paditësit av. XH.M. në seancën e sotme kryesore ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiës, i propozon gjykatës që që në bazë të faktëve dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës të vendos në bazë të nenit 43 të LKA-së dhe ta anuloj aktin e kontestuar administrative të të paditurës.

E paditura me anë të përgjigjes në padi të datës 13.12.2013, ka theksuar se "mbetet në fuqi vendimi i MMPH-së, me nr. 4339/13, i dates 20.11.2013, për rrënimin e objektit në parcelën kadastrale nr. 136/8, ZK Gornja Sellë dhe vërtetohet se me dt. 02.12.2013, në MMPH, paditësi nuk ka dëshmuar asnjë dokumentacion teknik, të nevojshëm-Leje Ndërtimore të objektit, në ngastrat kadastrale nr.136/8, ZK Gornja Sellë".

Gjykata në seancën e dt. 06.07.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi nr.06/159 i dt. 03.12.2013, vendimi nr.4339/13 i dt. 20.11.2013, vendimi i 34/13 i dt. 15.11.2013, fleta poseduese e dates 28.06.2005, çertifikata e dt. 15.11.2013, aktvendimi i dates 22.06.2005, vërtetimi i dates 25.10.2007, skica e paluajtshmërisë, vendimi i dt. 04.10.1998, si dhe bëhet shiqimi në fotodokumentacionin i cili gjendet si provë në shkresat e lëndës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga aktvendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljt thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e aryeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një

mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çart dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetvetën, dhe i njëjti nuk përmban fare arsyetim. Në dispozitivin e të njëjtit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se "Urdhërohet pronari i këtij objekti, të ndërtuar brenda hapsirës së Planit rregullues Urban "Prevalla" në Prevallë, aprovuar nga Asambleja komunale –KK P. më nr, 01/011-35, të datës 22.06.2006, që në afat prej 15 ditësh të bëjë rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje ndërtimi në parcelën me numër: 136/8, Zona Kadastrale-Gornja Sellë. Poashtu, të bëhet pastrimi i zonës prej mbeturinave nga demolimi si dhe sanimin e sipërfaqës së degraduar natyrore konform peisazhit". Më tej thekson se: "Në rast se pronari i objektit nuk vepron sipas pikës (I) të këtij Vendimi, MMPH do të bëjë rrënimin e objektit dhe shpenzimet do ti bartë pronari i objektit".

Në këtë kuptim gjykata gjenë se e paditura ka marrë një vendim pa dispozitiv të sakt dhe pa arsyetim, duke cituar si më lartë, duke marrë një vendim i cili nuk i përmban elementet kryesore të vendimit të përcaktuar me dispozitat ligjore të cekura më lartë të ligjit të procedurës administrative.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cakura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i menjanojë të metat e cekura, të marrë aktvendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
A.nr.1546/2013, dt.06.07.2016

Procesmbajtësja  
Nazmije Beka

G j y q t a r j a  
Delushe Halimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.